

20240841685

## ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 alinesë 5 të Ligjit të Tregtisë (\*) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 16/04, 128/06, 63/07, 88/08, 159/08, 20/ 09, 99/09, 105/09, 115/10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16 dhe 120/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.77/21, 215/21, 295/21 dhe 150/22), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 9 prill 2024, solli

### V E N D I M PËR NDALIMIN E SHITJES SË PRODUKTEVE TË CAKTUARA TË NAFTËS

#### Neni 1

Personave juridik dhe fizik që kryejnë tregti të derivateve të naftës me pakicë, u ndalohet të kryejnë tregti të vajit për djegje të vajit ekstra të lehtë për amvisëri EL-1 me përmbajtje të sulfurit më së shumti deri më 0,1% (m/m), në pikat e karburanteve në periudhën nga 15 prilli deri më 15 tetor 2024.

Prodhuesve, shitësve me shumicë dhe importuesve të derivateve të naftës u ndalohet të kryejnë shitje të vajit për djegje të vajit ekstra të lehtë për amvisëri EL-1 me përmbajtje të sulfurit më së shumti deri më 0,1% (m/m), për tregtarët e vajit (pikat e karburanteve), në periudhën nga 15 prilli deri më 15 tetor 2024.

#### Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 41-3262/6  
9 prill 2024  
Shkup

Kryetar i Qeverisë së Republikës  
së Maqedonisë së Veriut,  
Mr. **Talat Xhaferi**, d.v.